

D E K R E T
Nr.1255, datë 19.10.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 “PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7936, datë 18.5.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore””, në sistemin tarifor të nomenklaturës së mallrave bëhen këto ndryshime:

a. Në seksionin 2, kapitulli 10, numri i kreut 10.01 dhe me kod doganor 1001.10 e 1001.90 “Grurë dhe meslin”; b.Në seksionin 2, kapitulli 10, numri i kreut 10.05 dhe në kod doganor 1005.10 e 1005.90 “Misër”; c.Në seksionin 2, kapitulli 2, numri i kreut 11.01 dhe me kod doganor 1101.00 “Miell gruri dhe miell meslini”; d. Në seksionin 2, kapitulli 2, numri i kreut 1102 dhe me kod doganor 1102.20 “Miell misri (si drith)”; tarifatat doganore të ndryshohen nga 7 për qind në 0 për qind.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 10.6.1996.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha